



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



02/ Nr.

7286

Data: 04.09.2025

**PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR NË SEÇISHTË PËR DRAFT BUXHETIN  
PËR VITIN 2026 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2027-2028**

Procesverbali nga Dëgjimi i nëntë Buxhetor në lidhje me Draft Buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028, të mbajtur me datën **14.08.2025**, duke filluar nga ora **19:00** në SHFMU “**Ilaz Thaçi**” – Paralelja në Seçishtë, me gjithsej 10 pjesëmarrës/e, prej tyre 3 gra dhe 7 burra. Nga ekzekutivi, të pranishëm ishin Shefja e Kabinetit të Kryetarit, **znj.Liridona Ballazhi**, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, **znj.Lindita Ballazhi**, si dhe disa nga drejtorët/et e drejtorive.

Takimin e kryesoi Shefja e Kabinetit të Kryetarit, **znj.Liridona Ballazhi**, e cila iu uroi mirëseardhje të pranishmëve, të cilët kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin buxhetor për prezentimin e draft buxhetit të Komunës Hanit të Elezit për vitin 2026, si dhe parashikimi për vitet 2027-2028, ku për rend të punës, kishte:

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028**
2. **Diskutimi**

**Liridona Ballazhi:** Jemi në proces të realizimit të dëgjimeve buxhetore për Draft Buxhetin e komunës për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027-2028, ku këtë herë jemi në fshatin Seçishtë, ku pas prezentimit nga drejtoresha të draft buxhetit, ne presim rekomandimet, propozimet apo kërkesat tuaja.

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028**

(Drejtoresha Lindita Ballazhi përshëndet dhe falënderon të pranishmit për pjesëmarrje në dëgjim buxhetor të radhës në fshatin Seçishtë.)

**Lindita Ballazhi thekson:** Buxheti në disponim për vitin 2026 është 4,234,682 €, prej tyre e dedikuar për investime kapitale është shuma 891,140 €, pra këtë shumë ne mund ta shpenzojmë për projekte të ndryshme kapitale, ku para vetes keni fletushkat e përgatitura nga Instituti GAP, të cilën janë të listuara projektet kapitale, ku ka projekte që barten vit pas viti, por edhe projekte tjera të propozuara nga qytetarët. Nëse keni ndonjë propozim, ne jemi të hapur për t'i dëgjuar dhe më pas këto do të dërgohen për diskutim dhe shqyrtim me grupin punues për hartimin e draft buxhetit.

## 2. Diskutimi

**Liridona Ballazhi:** Pas prezantimit nga drejtoresha, unë e hap diskutimin për të pranishmit. Nëse keni ndonjë sugjerim, rekomandim, kërkesë për buxhetin e vitit 2026.

**Mevludin Kuka:** Si administrator, ne veçse jemi dakordu edhe herëne fudnit që kemi mbajtur debat mbi projektet prioritete që kemi, ku ne i kemi pasur këto kërkesa:  
-rehabilitimin e rrugës kah vorba;  
-shtrimi me kubëza betoni te burimi

**Mervet Kalisi:** Ne e kemi pas edhe vendosjen e shenjave, po gjithashtu edhe është kërku edhe rruga kah vorbat që e parashtrij si kërkesa me vite. Gjithashtu edhe kanalizimi te lagja që nuk ka momentalisht kanalizim, edhe ajo duhet me u rregullu kanalizimi për atë pjesë. Unë kisha kërku që edhe Seçishta me u përfshi ma shumë në realizim të projekteve se m'doket ma shumë është tu punu në pjesa tjera e në Seçishtë shumë pka, ku edhe ne kemi probleme me ndriçim, me ujë e krejt problemet e tjera si çdo lokalitet, po s'paku investimet me u bo njëtrajtshëm edhe për Seçishtë.

**Lindita Ballazhi:** Të gjitha projektet që i keni kërku në KAB janë futur në draft buxhet dhe nëse keni edhe kërkesa të reja do të hyjnë edhe ato se nuk besoj se ka pengesa për to, dhe është punu edhe për pjesën e Seçishtës, ku është ura e Seçishtës, e paoshtu edhe rruga Adem JAsahri dhe 11 Qershori, ku nëse deri ma herët kemi prit në kolona ka gjysëm ore ose më shumë, sot nuk janë këto pengesa, pra nuk mendoj se ka projekte që janë të dedikuara vetëm për atë apo këtë pjesë, por ka projekte për përfitojnë të gjithë.

**Mervet Kalisi:** Masi u përmën ura e Seçishtës, ne kemi pas kërkesë që ajo pjesa e kambësorëve me u shtu edhe pjesën tjetër, më janë dhënë zotime që kryhet por deri sot nuk është shtu ajo pjesë.

**Mevludin Kuka:** Për projekte të mëdhaja nuk idhnohemi se ndoshta edhe s'janë mundësitë, por së paku kërkesat e vogla me na i rregullu, ku kemi kërku vendosjen e tabelave për kufizim të shpejtësisë 30km/h dhe për 5 ton, tabela për ndalim parkingu prej fillimit e deri në fund të Seçishtës që mos mu parku rrugës, por edhe pasqyra, ku aty nashta vet jemi fajtor kur e dijmë kush i then po nuk tregojmë, sepse pasqyra ka qenë por është thy, dhe tash është e nevojshme me u vendos. Gjithashtu kah kjo rruga kah shpia e Ibush Shkretës, kemi kërku me u rregullu ndriçimi sepse ka probleme, dhe jo vetëm aty por edhe pjesë tjera.

**Liridona Ballazhi:** Këto kërkesa të fudnit më shumë janë kërkesa që s'ka nevojë për vitin e ardhshëm, sepse përmes shërbimeve publike munden me u krye dhe besoj se po të ishte drejtori këtu do të përgjigjej ma saktë, por sipas informacioneve që kam, projektet për ndriçimin publik është në procedurë tenderimi, ndoshta ka mbetë detajet e fundit, nënshkrimi i kontratës apo diçka e tillë, por besoj se pjesa e ndriçimit mundet me u rregullu brenda kohe të shkrutër, gjithashtu edhe kërkesat e tjera për tabela apo pasqyrë, do ta njoftojmë drejtorinë përkatëse që të marrë hapa konkretë sa ma shpejtë

**Ibush Shkreta:** Unë kam kërkesë, por edhe si lagje apo si fshat e kemi diskutu, që ne kemi ujësjellësin, por a do të ishte e mundur me rregullu puse ose diçka të tillë që edhe tek ne me mundësu ujin nëpër shpia, 80-100 shpia sa jemi sepse uji është prioritet. Në qet mahlalë ku jam unë, për momentin mundem em thanë që janë 3-4 shpia që janë hiç pa ujë dhe dueht me u bo një zgjidhje për krejt se gati se gjithkund është tu pas problem me ujë. Dhe kërkesë tjetër është se qe tre vite tek kjo rruga ktu kah sokaku knej përpjetë ktu afër, ku edhe jetoj unë, qe tre vite ajo rrugë është në terr, dhe jo vetëm terr po edhe shtyllat janë laku e janë të kapme, as nuk janë të sigurta. Përveç kësaj ka edhe shakte që janë thy se janë kualitet i dobët, e gjithashtu te këto shakte nuk ka siguri se lirisht kushdo mundet me hjek shaktin, e s'paku me u lidh najqysh ose diçka me bo që mos me pas mundësi me i hjek shaktet apo kapakëte pusetave.

**Mevludin Kuka:** Si administrator i fshatit, bashkë me drejtorin ne kur të lidhet kontrata me operatorin për ndriçimin, ne kemi me dal bashkë, kemi me i evidentu krejt parregullsitë me drita, edhe pse e kemi bërë edhe para pak kohe, e dimë paka shumë ku ka probleme, edhe kanë me u rregullu të gjitha ku janë me probleme ose të prishta. Shpesh janë riparuar dhe besoj se edhe kto rregullohen.

**Mërgim Shkreta:** Te furra "Mali" aty nuk ka shenjzim as për këmbësor as kurrfar shenjzimi, vija u fshi dhe është shumë rrezik. Po ashtu për te shaktet, dy tre herë i kam rregullu vet sepse po thehen, nuk di a kualitet ma i dobët a çka, po duhen me u rregullu.

**Liridona Ballazhi:** Ne do t'i marrim të gjitha rekomandimet tuaja, do t'i shënojmë dhe do t'i shqyrtojmë. A ka edhe dikush diçka me shtu apo me plotësu? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur dëgjimin buxhetor.

Mbledhja përfundoi në ora 19:40.

Procesmbajtësja  
Liridona Ballazhi

